

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“HORIZON INVEST” SHPK**

---



# AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## "HORIZON INVEST" SHPK

(Hartuar në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar)

### KREU I EMRI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Sot, në Tiranë më datë 24.02.2025:

Ne, **Artan Dulaku**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30.05.1965, mbajtësi i kartës së identitetit nr. 035434059 dhe numër personal G50530166T, **Genci Dulaku**, i datëlindjes 19.12.1967, mbajtësi i kartës së identitetit nr. 036045039 dhe numër personal G71219083M dhe **Erjon Harizi**, i datëlindjes 19.10.1979, mbajtësi i kartës së identitetit nr. 037658393 dhe numër personal H91019106G, themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "**HORIZON INVEST**" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

### Neni 1 FORMA E SHOQËRISË

- 1.1. Ortakët themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në kuptimin që përgjegjësia e tyre është e kufizuar deri në shumën e kapitalit të derdhur, pa iu njohur asnjë përgjegjësi tjetër.
- 1.2. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi.

### Neni 2 EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 2.1. Emërtimi i shoqërisë është "**HORIZON INVEST**" SHPK.
- 2.2. Emërtimi dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.

### Neni 3 BAZA JURIDIKE

- 3.1. Shoqëria "**HORIZON INVEST**" SHPK e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3.2. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e Akt Themelimit dhe Statutit.

### Neni 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1. Shoqëria "**HORIZON INVEST**" SHPK ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë : "**HORIZON INVEST**" SHPK

4.2. Shoqëria ka si qëllim dhe objekt prioritar kryerjen e veprimtarive të promovimit dhe realizimit të investimeve të ndryshme si dhe të punimeve ndërtimore sipas kategorive të specifikuara si vijon: Punime dheu, sisteminë, tarracime terrenesh etj. Prodhim material inerte, rërë, çakëll, gurë, mermere etj. Prodhim elementesh të parafabrikuara, betoni e b/armeje. Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj. deri në dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme. Rikonstrukcione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj. Mirëmbajtja, zhvillimi i dekorit në mjedise urbane. Shoqëria do të ushtrojë veprimtaritë e shitblerjes, promovim realizim i investimeve dhe punimeve ndërtimore të të gjitha kategorive, shitblerje marrje dhënie me qera të pasurive të paluajtshme, import-eksport transport tregti mallra të ndryshme, asistencë konsulencë ligjore, perfaqësim ndërmjetësime të ndryshme, leasing etj. Shoqëria do të ushtrojë veprimtaritë e shitblerjes të marrjes ose dhënies me qira të pasurive të luajtshme, të atyre të paluajtshme si ndërtesa apo pjesë të tyre të çdo lloji, 2 troje dhe të tjera të ngjashme duke themeluar për këtë qëllim dhe nëse e gjykon me interes zyrtar dhe agjensitë përkatëse. Gjithashtu, shoqëria mund të ushtrojë veprimtari për financimin e ndërtimeve të objekteve të natyrave të ndryshme. Shoqëria ka të drejtë të kryejë çdo lloj operacioni dhe transaksioni në lidhje me importimin, eksportimin, tranzitimin, transportimin dhe tregtimin e mallrave të ndryshme si materiale ndërtimi, hidrosanitare e të tjera të lidhura me industrinë e ndërtimit, atyre ushqimore, elektroshtepiake, të mobiljeve, pijeve të ndryshme, veshjeve e konfeksioneve si edhe mallra të tjera me shumicë e pakicë në natyrën e lëndës së parë, produkteve gjysëm të gatshme apo të gatshme, makinerive e pajisjeve, teknologjive etj. Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari për dhënien e asistencës dhe konsulencës teknike, ligjore dhe të menaxhimit të veprimtarive të çdo lloji dhe në veçanti në fushat të cilat kanë lidhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Shoqëria mund të ushtrojë edhe veprimtarinë e përfaqësimit, të ndërmjetësimit apo të agjensisë për persona fizikë apo juridikë, subjekte publike, shtetërore apo private, vendas apo të huaj. Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera tregtare dhe gjithashtu, mund të japë ose të përfitojë leasing, të gjitha këto mbi pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, makineri, pajisje të çfarëdo lloji dhe gjithashtu mund të kryejë çdo lloj veprimi tjetër me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, veprime financiare duke përfshirë këtu dhe factoring, tregtare, të gjitha këto të quajtura të nevojshme dhe të dobishme për realizimin e qëllimeve të objektit të veprimtarisë së shoqërisë. Shoqëria ka të gjitha të drejtat për të marrë pjesë në fitimet dhe/ose në shoqëri të tjera të së drejtës shqiptare ose të shteteve të tjera dhe të themelojë shoqëri të tjera me individë ose persona juridikë, subjekte publike ose private, vendas ose të huaj. Blerje-shitje pasuri të paluajtshme e të luajtshme, pasuri këto në pronësi të shoqërisë "ORIK INVEST" SHPK ose të personave fizikë apo juridikë të tjerë. Kryerja e analizave për materialet e ndërtimit (beton, inerte etj) të vetë shoqërisë ose të palëve të treta. Studim, projektim, nxjerrje, përpunim, tregtim, eksport-import i të gjitha llojeve të mineraleve të dobishëm dhe mineraleve ndërtimorë, e të tjera sipas klasifikimit të Ligjit Nr. 10304 datë 15.07.2010 për Sektorin Mineral në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Përdorimi shitje, blerje i materialeve plasëse për qëllimin e shfrytëzimit të mineraleve të dobishëm dhe mineraleve ndërtimorë, e të tjera konform ligjeve. Import-eksport, tregtim shitje-blerje të makinerive dhe pajisjeve për qëllimin e shfrytëzimit të mineraleve të dobishëm dhe mineraleve ndërtimorë, e të tjera.

Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

- 4.3. Për të realizuar qëllimet e saj Shoqëria mund të sigurojë dhe përdorë financime nga ortakët, nga vende të tjera ose nga institucione financiare vendase ose të huaja.
- 4.4. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj dhe emërtimin me vendim të Asamblesë së ortakëve, në përputhje me legjislacionin dhe regjistrohet në QKB dhe në Organet Tatimore.
- 4.5. Shoqëria **"HORIZON INVEST" SHPK** do të ushtrojë veprimtarinë për ato aktivitete që kërkojnë marrjen e licencave dhe lejeve përkatëse vetëm pas marrjes së tyre nga organet dhe strukturat e caktuara nga ligji.
- 4.6. Shoqëria **"HORIZON INVEST" SHPK** do të ushtrojë veprimtarinë në përmbushje të objektit të veprimtarisë së saj, duke zbatuar të gjithë ligjet dhe aktet nënligjore rregulluese në lidhje me licencimin, kushtet, procedurat dhe afatet e kërkuara.
- 4.7. Gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të saj Shoqëria **"HORIZON INVEST" SHPK** do të zbatojë standardet më të larta të etikës profesionale dhe zbatimit të ligjshmërisë.

#### Neni 5 SELIA

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Njësia Administrative Petrelë, Fshati Stërmas, Tiranë". Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin dëgje dhe/ose zyra përfaqësimi apo agjenci të saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

#### Neni 6 KOHËZGJATJA

- 6.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

### KREU II KAPITALI I SHOQËRISË DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### Neni 7 KAPITALI I SHOQËRISË

- 7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 3 (tre) kuota.
- Z. Artan Dulaku zotëron 1(një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 37,5% të tij në vlerën 37.500 (tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë, Z. Genci Dulaku zotëron 1(një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 37,5% të tij në vlerën 37.500 (tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë dhe Z. Erjon Harizi zotëron 1(një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 25% të tij në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë. Derdhja e kapitalit do të kryhet pas regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.
- 7.2. Çdo pjesë e kapitalit themeltar i jep të drejtën e një vote zotëruesit të saj.
- 7.3. Ortakët e Shoqërisë **"HORIZON INVEST" SHPK** përgjigjen për detyrimet ndaj të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në formimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

### Neni 8

## TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

- 8.1. Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, dhurim, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 8.2. Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat. Mosrespektimi i kësaj dispozite e bën të pavlefshëm transferimin e kuotave.
- 8.3. Vlera e kuotës që transferohet do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakord.

### NENI 9

## ZMADHIMI I KAPITALIT

- 9.1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet me vendim të ortakëve, në përputhje me Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, në bazë të raportit të Administratorit të Shoqërisë.
- 9.2. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet me anë të kontributeve të reja në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave dhe fitimit si pjesë të Kapitalit Themeltar.
- 9.3. Në rast zmadhimi të kapitalit me anë të kontributeve në para, të gjitha pjesët e reja të Kapitalit duhet të nënshkruhen dhe të shlyhen tërësisht nga Ortaku. Ato duhet të depozitohen nga nënshkruesit në Bankë për llogari të Shoqërisë **"HORIZON INVEST" SHPK**.

### NENI 10

## ZVOGËLIMI

- 10.1. Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet me vendim të ortakëve, në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 10.2. Zvogëlimi i prek Ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata zotërojnë.

### KREU III

## ORGANET E SHOQËRISË DHE FINANCIMET

### Neni 11

## ORGANET E SHOQËRISË

- 11.1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
- b) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë;

Neni 12  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 12.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.
- 12.2. Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.
- 12.3. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji për shoqëritë tregtare, ligje të tjera, dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.
- 12.4. Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zotërojnë jo më pak se 100% të vlerës nominale të kuotave. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i, për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.
- 12.5. Mosveprimi i paqëllimtë për dhënien e për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mosmarrja e këtij njoftimi nga personat që kanë të drejtën për t'a marrë një njoftim të tillë, i bën vendimet e Asamblesë të pavlefshme, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.
- 12.6. Administratori mund të thërrasë mbledhjen e Asamblesë kur ta mendojë të arsyeshme vetë dhe/ose sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me nenin 84 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar
- 12.7. Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtëzakonshme.

Neni 13  
**VENDIMET E ASAMBLESE**

- 13.1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në nenin 86 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Ortakët ose zotëruesi i prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas nenit 88 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë, së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë.
- 13.2. Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar mbledhjen ose një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- 13.3. Nëse anjëri prej administratorëve nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes ose nëse asnjëri prej tyre nuk është i pranishëm për 15 minuta duke filluar nga ora e caktuar për të mbajtur mbledhjen, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.
- 13.4. Pavarësisht nëse është ortak apo jo, administratorit i lejonet të marrë pjesë dhe të flasë në

mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

- 13.5. Me pëlqimin e ortakëve të pranishëm, Kryetari mundet (dhe është i detyruar nëse ia kërkon Asambleja), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë, por në mbledhjen e shtuar nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave që mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishte ndërprerë dhe shtyrë mbledhja. Kur mbledhja shtyhet për 14 ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim për të paktën 7 ditë, në të cilin, të përcaktohen data dhe ora e mbledhjes së shtyrë si dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.
- 13.6. Vendimet që duhen miratuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit nuk është kërkuar një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë Kryetari ose një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se 5% të votave gjithsej të Asamblesë së Përgjithshme. Kërkesa e bërë nga një person që ka Prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.
- 13.7. Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me shumicë të caktuar është e formës së prerë dhe nuk është e nevojshme prova e numrit apo % së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 13.8. Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave pro dhe kundër vendimit.

#### Neni 14 VOTAT E ORTAKËVE

- 14.1. Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secili ortak i pranishëm ose i përfaqësuar, ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.
- 14.2. Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.
- 14.3. Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi, i bëhen në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Të gjitha votat e pahequra në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë, janë të vlefshme.

#### Neni 15 HETIMET E POSAÇME

- 15.1. Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posaçëm sipas nenit 91 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, e bëjnë këtë kërkesë duke depozituar në selinë e shoqërisë një dokument së bashku me një deklaratë noteriale, e cila, vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

KREU IV  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË DHE SHPËRBLIMET**

**Neni 16**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**16.1. Shoqëria administrohet nga një Administrator**

**Erjon Harizi**, i datëlindjes 19.10.1979, mbajtësi i kartës së identitetit nr. 037658393 dhe numër personal H91019106G, i cili emërohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat komiteteve që përbëhen nga nga një ose më shumë administratorë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vendosin administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet.

**16.2. Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:**

- a) mbikëqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
- b) përfaqëson Shoqërinë;
- c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklarim tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të certifikuar dhe raporti i llogaritarëve publikë të certifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;

**16.3. Administratori mund të ndërmarrë apo të kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë.**

**16.4. Përveç sa më sipër, Administratori ka këto kufizime kompetencash:**

a) Administratori i shoqërisë nënshkruan/autorizon çdo transaksion bankar deri në shumën prej Euro 50.000 (pesëdhjetë mijë) ose kundërvlerën në lekë ose çdo valute tjetër, në ditë, në çdo bankë të nivelit të dytë, në një limit mujor për transaksione agregat me përfitues të ndryshëm prej Euro 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) ose kundërvlerën në lekë ose çdo valute tjetër. Në rast të tejkalimit të shumes për një transaksion të vetëm ose të limitit mujor të përcaktuar në këtë paragraph, operacioni përkatës do të miratohet nga Administratori së bashku me firmën e ndonjërit prej ortakëve Z. Artan Dulaku ose Z. Genci Dulaku ose çdo personi që mund të autorizohet posaçërisht për një transaksion specifik ose përgjithësisht për çdo transaksion që përfshihet në këtë paragraf, sipas një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

b) Administratori i shoqërisë së bashku me ndonjërin prej ortakëve të shoqërisë ndërmjet Z. Artan Dulaku ose Z. Genci Dulaku ose çdo personi që mund të autorizohet posaçërisht për një transaksion specifik ose përgjithësisht për çdo transaksion që përfshihet në këtë paragraf, sipas një vendimi të

Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve, do të nënshkruajë çdo marrëveshje tregtare ose kontratë, nëpërmjet së cilës shoqëria përfiton ose tjetëron pasuri të paluajtshme në kuadër të marrëdhënieve të shkëmbimit mall/shërbim me mall/shërbim (kling)

c) Administratori i shoqërisë ka të drejtë të nënshkruajë hua, kredi, discounts dhe çdo ofrim fondesh, që përbën një kredi ose debi për shoqërinë, vetëm në bazë të një vendimi miratues të Asamblesë së ortakëve.

d) Administratori i shoqërisë veçmas mund të nënshkruajë dhe ndërmarrë çfarëdolloj veprimi ose operacioni shitblerje normale (të punës, në cilësinë e furnizuesit ose të të furnizuarit) për një kontratë/marrëveshje me çdo subjekt tregtar deri në shumen prej Euro 50.000 (pesëdhjetë mijë) ose kundërvlerën në lekë ose çdo valute tjetër, ndërsa në agregat operacionesh në tërësi gjatë një muaji kalendarik deri në shumen prej Euro 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) me të gjithë klientët/furnitorët. Në rast të tejkalimit të limiteve të përcaktuar në këtë paragraph, operacioni përkatës do të miratohet me kundër firmën e ndonjërit prej ortakëve të shoqërisë ndërmjet Z. Artan Dulaku ose Genci Dulaku ose çdo personi që mund të autorizohet posaçërisht për një transaksion specifik ose përgjithësisht për çdo transaksion që përfshihet në këtë paragraf. Sipas një vendimi të Asamblese së Përgjithshme të ortakëve.

Kufizimet e mësipërme nuk janë të aplikueshme për çdo transaksion që ka për qëllim pagesat e detyrueshme të lidhura me administrimin e zakonshëm të aktivitetit të shoqërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në pagesën e taksave, tarifave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagat e punëmarrësve, detyrimet për furnitorët e energjisë elektrike dhe ujit, gjobat dhe penalitetet që lidhen me to, të cilat administrator mund t'i autorizojë dhe kryejë i vetëm.

#### Neni 17

### SHKARKIMI DHE LARGIMI I ADMINISTRATORIT

17.1. Administratori shkarkohet ose lirohet nga detyra nëse:

- a) pushon së qeni administrator në bazë të dispozitave të nenit 95/6 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar
- b) shoqëria hyn në procedurën e paafësisë paguese
- c) vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore
- d) jep dorëheqjen
- e) ka munguar për më shumë se 2 muaj rradhazi, pa leje, në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë
- f) Asambleja e Përgjithshme, me propozim të ortakëve, vendos ta lirojë nga detyra

#### Neni 18

### SHPËRBLIMI I PUNËS, PËRFITIMET E TJERA DHE SHPENZIMET E ADMINISTRATORIT

18.1. Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë në përputhje me nenin 97 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar

18.2. Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera, të cilat janë ose kanë filiale të shoqërisë, ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë

ekzistuese, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish bashkëshortin ose ish bashkëshorten) ose për personat në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla (si përpara ashtu edhe pasi personi në fjalë të pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).

- 18.3. Administratorit i paguhet të gjitha shpenzimet e udhëtimit, qëndrimit apo të tjera, që u lindin në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhjet apo të komiteteve, ose në mbledhjet e Asamblesë apo mbledhje të veçanta të zotëruesve të klasave të aksioneve të shoqërisë, si dhe shpenzimet që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre.

#### Neni 19

### VENDIMET E ADMINISTRATORIT

- 19.1. Mbledhjet e administratorit mbahen sa herë ta kërkojë aktiviteti i shoqërisë.

- 19.2. Të gjitha aktet e administratorit ose çdo personi që ushtron detyrën e caktuar prej tij, pavarësisht faktit se më vonë zbulohet se ka patur mangësi në emërimin e tij ose ka qenë i skualifikuar nga e drejta për të mbajtur detyrën ose nuk ka patur të drejtë vote, janë të vlefshme sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht, të plotësonin kushtet, të vazhdonin të ishin administratorë.

#### Neni 20

### KUFIZIMET PËR VOTIMIN

- 20.1. Një administrator nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk merr vendime për asnjë çështje në të cilën ka, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas nenit 13 të Ligjit, nëse me vendim Asambleje nuk është rënë dakord:

a) të autorizohet lidhja e marrëveshjeve nga ana e tij

b) të autorizohet të vendosë për çështjet në fjalë

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### KREU V

### KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI

#### Neni 21

### KONTROLI KONTABËL

- 21.1. Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

**Neni 22**  
**VITI FINANCIAR**

- 22.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 23**  
**BILANCI DHE REZERVAT**

- 23.1. Me mbylljen e secilit vit financiar Administratorët marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur në mënyrë që ortakët të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 23.2. Ortakët vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 23.3. Ortakët në çdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**Neni 24**  
**KAPITALIZIMI I FITIMEVE**

- 24.1. Me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke patur në konsideratë parimet e vendosura në nenin 14 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, administratorët mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferencialë ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

**Neni 25**  
**DIVIDENTËT**

- 25.1. Pas përmbushjes së kërkesave të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 25.2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim me shumën e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend, duke filluar nga një datë e caktuar atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.
- 25.3. Secili ortak mund t'i paraqesë kërkesë administratorit që në mbledhjen e Asamblesë për miratimin e rezultateve financiare dhe destinimin e të ardhurave vjetore të merret në shqyrtim pagimi i dividendit që do t'i përkiste këtij ortaku. Në rast se, pagesa e dividendit është e pranueshme në përputhje me rezultatet e aktivitetit të shoqërisë si dhe në përputhje me parashikimet e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, administratori e përfshin këtë kërkesë në rendin e ditës të mbledhjes së Asamblesë. Ortakët nuk mund të pengojnë, qoftë edhe me vendim të veçantë të shumicës, pagimin e dividendit për një apo disa ortakë të cilët kërkojnë shpërndarjen e dividendit.

- 25.4. Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria, nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.
- 25.5. Nëse një dividend nuk është tërhequr pas 12 viteve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

## **KREU VI PRISHJA DHE NJOFTIMET**

### **Neni 26 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 26.1. Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (të ndryshuar).

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm ose asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) me vendim të gjykatës;

### **Neni 27 NJOFTIMET**

- 27.1. Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorëve të Shoqërisë. Për këtë qëllim, brenda 5 (pesë) ditëve nga regjistrimi efektiv i çdo ortaku (si i tillë) në regjistrin tregtar, ky i fundit është i detyruar ti komunikojë administratorit adresën postare dhe adresën postare elektronike ku dëshiron të marrë njoftimet. Brenda të njëjtit afat i komunikon administratorit të shoqërisë adresën e re, kur adresa ndryshon, në të kundërt njoftimi konsiderohet si i kryer rregullisht.
- 27.2. Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3. Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

**KREU VII**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 28  
**LIGJI I ZBATUESHËM**

28.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statutin e shoqërisë, si dhe me ligjin shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre janë Gjykatat Shqiptare.

28.2. Ky Akt hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortakët themelues, firmoset si më poshtë prej tyre.

**ORTAKËT**

Artan Dulaku



Genci Dulaku



Erjon Harizi

